



Pranimi / Dorezuar Priljepra/Prifato Received/Delivered	14.06.2022	viti god year	2
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	In Prof Rr Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHICK	3481/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.437/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Flakron Gashi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.437/2022 të datës 04.05.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] përmes avokatit të autorizuar [redacted] me adresë [redacted] në Komunën Prishtinës, kundër Vendimit me numër KD.nr.028/2021 të datës 21.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër KD.nr.028/2021 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës i datës 21.03.2022 dhe *lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.*
- II. OBLIGOHET Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarë të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën I të dispozitivit.
- III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që të ndërmarë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 20.09.2021 ka nxjerr vendim me Nr.01058 për formimin e Komisionit Hetimore për hetim të brendshëm administrativ lidhur me dyshimet e ngjarjes në Qendrën Korrektues për të Mitur në Lipjan për një ngacmim nga ana e një arsimtari të ndodhur më datës 17.06.2021. Komisioni Hetimor më datë 02.11.2021 ka nxjerr Raport Përfundimtar të Hetimeve ku pas deklaratave të personave ka gjetur shkelje gjatë këtij procesi dhe ka rekomanduar Komisionin Disiplinor të ndërmarr masat disiplinore në pajtim me ligjet në fuqi.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, bazuar në raportin e Komisionit Hetimor, më datë 14.12.2021 ka parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit pranë Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë, më datë 22.12.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 165/2021 me të cilin ankuesin e ka shkarkuar nga detyra e Drejtorit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, ndërsa pas këtij Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 23.12.2021 ka marr Vendim me Nr.0281 me të cilin e ka përfunduar procedurën disiplinore, me arsyetimin se të njëjtit ju ka ndërprerë marrëdhënia e punës nga Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë dhe se është konsumuar objekti mbi të cilin është filluar procedura disiplinore.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 165/2021 të datës 22.12.2021 të Ministres së Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës më datë 18.01.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila më datë 21.01.2022 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe regjistruar me numër të ankesën A.nr.46/2022, ndërsa Këshilli me datë 03.03.2022 ka nxjerr vendimin me numër A.nr.46/2022 dhe numër protokollit:1151/2022 përmes të cilit e ka aprovuar ankesën e ankuesit ndërsa e ka shfuqizuar Vendimit me Nr. 165/2021 të datës 22.12.2021 të Ministres së Ministrisë së Drejtësisë, respektivisht e ka obliguar Ministrinë e Drejtësisë që ankuesin ta kthej në pozitën të cilën e ka ushtruar paraprakisht, ndërsa sipas shkresave të lëndës Shërbimi Korrektues i Kosovës me datë 16.03.2022 me numër prot:1369/2022 e ka njoftuar Këshillin se është zbatuar vendimi A.nr.46/2022 i datës 03.03.2022 njëherit ankuesi është kthyer në vendin e punës Drejtori i Qendrës Korrektuese në Lipjan.

Me datë 18.03.2022 Kryesuesi i Komisionit Disiplinor ka nxjerrë vendimin me numër:0317 përmes të cilit e shfuqizon Vendimin e datës 23.12.2021 me Nr.0281 të Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës njëherit e vazhdon procedurën disiplinore të ankuesit të inicuar sipas kërkesës Nr.1362 të datës 14.12.2021 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, bazuar në raportin e Komisionit Hetimor, ndërsa me datë 21.03.2022 Komisioni Disiplinor nxjerrë vendimin me numër:KD.nr.028/2021 përmes të cilit ankuesit i shqipton masën disiplinore "ndalim i 20% pagës për periudhën dy muaj".

Ankuesi kundër Vendimit me numër:KD.nr.028/2021 të datës 21.03.2022 i Komisionit Disiplinor të cilin sipas shkresave të lëndës e ka pranuar me datë 04.04.2022, me datë 28.04.2022 ka

parashtruar ankesë nëpërmjet postë e cila në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 04.05.2022 dhe është regjistruar me numër prot:2570/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.05.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Më datë 18.05.2022 nëpërmjet e-maili Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.05.2022 me numër te protokollit 2570/2022 te parashtruar nga ankuesi ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 30.12.2021; Vendimin e Komisionit Disiplinor me numër KD.nr.028/2021 të datës 21.03.2022; Vendimin e Kryesuesit të Komisionit Disiplinor të datës 18.03.2022; Deklaratën e datës 18.06.2022 e S.H; Deklaratën e datës 18.06.2022 e T.H; Shkresën e ankuesit të datës 18.06.2021; Njoftimin e datës 08.09.2021; E-mailin e datës 08.09.2021 dërguar nga A.B për A.G; E-mailin e datës 18.05.2022 dërguar nga M.S për këshillin; Shkresën me përgjigjen në ankesë e datës 18.05.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës që mban ankuesi; Kontratë e punës së ankuesit; Vendimin e Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK me numër:1088 të datës 24.09.2021 për transferimin e ankuesit; Flete kthesën e datës 04.04.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në *rishqyrtim*, duke e obliguar Komisionin Disiplinor të Shërbimit Korrektues të që të rivendos lidhur me rastin e inicimit të procedurës disiplinore për ankuesin

sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e Drejtorit të Qendrës Korrektues në Lipjan, ndërsa Komisionin Disiplinor përmes vendimit me numër KD.nr.028/2021 të datës 21.03.2022 i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore *"ndalimi i 20% të pagës për periudhën dy (2) muaj"*, me arsyetimin se ankuesi ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara si në nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafët 3.1, 3.3, 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë, si dhe nenin 8, 37 në lidhje me nenin 378, 414 të Kodit penal të Kosovës - Kodit nr.06/L074, nenit 114, neni 4 paragrafi 9 i Kodit të drejtësisë për të mitur Kodi Nr.06/L-006.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e nenit 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor"* ndërsa neni 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 i të njëjtit ligj përcaktojnë se: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*, andaj mbi këtë bazë kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e shqyrtimit të masës disiplinore ndaj ankuesit, ka dal jashtë autorizimeve dhe kompetencave ligjore kur ka bërë përcaktimin se ankuesi ka bërë shkelje të Kodit Penal të Kosovës - Kodit nr.06/L074 dhe Kodit

të Drejtësisë për të mitur Kodi Nr.06/L-006, pasi ndaj nëpunësve civil mund të shqiptohen masa disiplinore vetëm në kuptim të përcaktimit si në nenin 46 paragrafi 1 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore"* në kuptim të paragrafit 2, 3 dhe 4 të nenit 46 të të njëjtit ligj.

Andaj, meqenëse Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.028/2021 të datës 21.03.2022, në dispozitiv i është referuar edhe shkeljes të Kodit për të Mitur dhe Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke konstatuar që përgjegjësia e ankuesit përbënë edhe shkelje me elemente penale, në këtë kuptim, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konsideron që Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullorja (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, nuk i ka dhënë kompetencë Komisionit Disiplinor të konstatoj që shkeljet eventuale të nëpunësve civil të trajtohen me elemente të procedurës penale, respektivisht Komisioni Disiplinor ka dal jashtë autorizimeve të përcaktuara me ligjin material, andaj në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 5. është në kundërshtim me ligjin material"*, Kolegji konstaton se Vendimit me numër:KD.nr.028/2021 i datës 21.03.2022 i Komisionit Disiplinor është akt i paligjshëm dhe si i tillë është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi dhe lënda është kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje në Komisionin Disiplinor, ndërsa për shkak të metave juridike të vendimit të ankimuar Kolegji nuk ka mundur të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar ligjshmërinë e vendimit me numër:0317 të Kryesuesit të Komisionit Disiplinor i datës 18.03.2022, përmes të cili është bërë shfuqizimi i Vendimit të datës 23.12.2021 me Nr.0281 i Komisioni Disiplinor njëherit është vazhduar procedura disiplinore ndaj ankuesit e iniciuar sipas kërkesës Nr.1362 të datës 14.12.2021 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, si rrjedhojë Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 57 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj, pa rënë kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni"*, dhe mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar se me rastin e shfuqizimit të Vendimit me Nr. 165/2021 të datës 22.12.2021 të Ministres së Ministrisë së Drejtësisë, nga ana e Këshillit përmes Vendimit A.nr.46/2022 të datës 03.03.2022 respektivisht institucioni punëdhënës e ka kthyer ankuesin në pozitën të cilën e ka ushtruar paraprakisht sipas aktit të themelimit të marrëdhënies së punës, andaj edhe kanë ndryshuar rrethanat faktike ngase mungesa e objektit të shqyrtimit për shkak të cilit Komisioni Disiplinor me Vendimin e datës 23.12.2021 me Nr.0281 e kishte përfunduar procedimin administrativ tanimë është rikthyer pasi që ankuesi është kthyer në vendin e punës andaj Kolegji vlerëson se në rastin e tillë Komisioni Disiplinor kur e ka rihapur procedurën disiplinore ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Me datë 18.03.2022 Kryesuesi i Komisionit Disiplinor ka nxjerrë vendimin me numër:0317 përmes të cilit e shfuqizon Vendimin e datës 23.12.2021 me Nr.0281 të Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës njëherit e vazhdon procedurën disiplinore të ankuesit të iniciuar sipas

kërkesës Nr.1362 të datës 14.12.2021 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, bazuar në raportin e Komisionit Hetimor, ndërsa me datë 21.03.2022 Komisioni Disiplinor nxjerrë vendimin me numër:KD.nr.028/2021 përmes të cilit ankuesit i shqipton masën disiplinore "ndalim i 20% pagës për periudhën dy muaj".

Andaj, Kolegji pas shqyrtimit të peshimit të provave të lëndës si dhe duke u bazuar në të gjeturat e pasqyruara në arsyetimin e këtij vendimi, ka vendosur që lënda të kthehet në rivendosje të organi i njëjtë, gjegjësisht tek Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe i njëjti në procedurë të rivendosjes, duhet t'i marr parasysh pikëpamjet juridike të këtij vendimi dhe t'i eliminoj të metat e konstatuara të aktit administrativ dhe të nxjerr vendim në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe masën të shqiptoj në raport të drejt me shkeljen e kryer dhe të bazohet në Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; Shkallën e fajësisë; Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; Përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit, siç parashihet me nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.437/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit firmës;
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

